



NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT

Udhëzues

FIUAD:40/2018
Datë: 26/02/2018

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E FINANCËVE - MINISTARSTVO ZA FINANSJE - MINISTRY OF FINANCE	
Njësia për Inteligjencë Financiare - Finansijska Obaveštajna Jedinica Financial Intelligence Unit	
Nr./Br. FIUAD: 40/2018	Nrfaq./br.str. -1-
Data/Datum 26/02/2018	
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

Drejtori i Njesisë për Inteligjencë Financiare në pajtim me kompetencat sipas nenit 14 pika 1.11 dhe nenit 66 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-096, për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (tutje PPP/LFT), me qëllim të implementimit të nenit 26, pika 1.2. të ligjit për PPP/LFT, NJIF-K përcakton afatin e Raportimit të Transaksioneve në të Gatshme (RTG) përmes këtij udhëzuesi:

- Bankat komerciale në Kosovë, udhëzohen që transaksionet në para të gatshme t'i raportojnë në NJIF-K në baza javore. Raportimi bëhet deri në ditën e Mërkur të javës pasuese për transaksionet e realizuara në javën paraprake.
- Avokatët, Noterët, Kontabilistët, Auditorët dhe Këshilltarët tatimor, udhëzohen që transaksionet në para të gatshme t'i raportojnë në NJIF-K brenda 15 ditësh nga data e realizimit të transaksionit.
- Institucionet financiare dhe subjektet e tjera raportuese të specifikuara në nenin 16 të Ligjit për PPP/LFT, udhëzohen që transaksionet në para të gatshme t'i raportojnë në NJIF-K në baza mujore. Raportimi bëhet deri me datë 15 të muajit pasues për transaksionet e realizuara gjatë muajit paraprak.
- Në rast se dita/data e raportimit të përcaktuar sipas këtij udhëzuesi rezulton të jetë ditë pushimi zyrtar apo vikend atëherë dita/data pasuese konsiderohet kohë e raportimit. Raportimi bëhet brenda orarit të rregullt të punës 08:00 – 16:00.
- Mos respektimi i këtij udhëzuesi paraqet shkelje administrative sipas nenit 41 pika 1.1. të Ligjit për PPP/LFT.
- Ky udhëzues mbetet në fuqi deri në një njoftim tjetër nga NJIF-K.

Me respekt,

Dardan NUHIU
Drejtor, Njësia për Inteligjencë Financiare

